

2019

# Përbledhje Jo-Teknike

**PROJEKTI: ‘DEPOZITAT  
NËNTOKËSORE TË GAZIT’,  
FUSHË-KRUJË**

**Kompania: “Fushe-Kruje Cement Factory” sh.p.k**

**Hartoi: “GR Albania” sh.p.k**

**Maj, 2019**

## Projekti: "Ndërtim i bazamenteve të depozitave të gazit", Fushë-Krujë

Porositës:	<p style="text-align: center;"><b>Subjekti</b> <b>"Fushë Krujë Cement Factory" sh.p.k</b></p>
Përgatitur nga:	<p style="text-align: center;"><b>Aulona Shalla</b> <b>Eksperte Mjedisi</b> Nr . Identifikues 475, date <del>22.09.2017</del> Nr. Protokolli <del>4948</del></p> <p style="text-align: center;"> GR ALBANIA Planning &amp; Environmental Consulting Company LN-4923-04-2012</p>
Maj, 2019	

### Tabela e përbajtjes

HYRJE.....	4
1. PËRSHKRIM I PROJEKTIT .....	6
2. PËRSHKRIM I MJEDISIT.....	9
3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS.....	10
4. KOHËZGJATJA E MUNDSHME E NDIKIMEVE .....	15
5. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE .....	16

### Liste e figurave

Figura 1: Harta topografike.....	4
Figura 2: Harta me vendndodhjen e 2 depozitave brenda fabrikes së çimentos.....	5
Figura 3: Foto nga terreni, vendi ku do të ndërtohet depozita $15 m^3$ .....	6
Figura 4: Pamje nga vendi ku do të ndërtohet depozita $35 m^3$ .....	6

### Liste e tabelave

Tabela 1: Koordinatat e projektit në studim.....	5
Tabela 2: Klasifikimi i ndikimit .....	11
Tabela 3: Shkalla e rëndësise sipas kodit të ngjyrave.....	12
Tabela 4: Kohëzgjatja e impaktit.....	12
Tabela 10: Sasitë e mbetjeve inerte .....	14
Tabela 11: Tabela me kodet e mbetjeve .....	15
Tabela 7: Masat për zbutjen e ndikimeve.....	16

## HYRJE

Subjekti "Fushe-Kruje Cement Factory" sh.p.k synon zhvillimin e projektit për ndërtimin e 'Bazamentit të depozitave të gazit', Fushë-Krujë, me vendndodhje në Njësinë Administrative Fushë Krujë, Qarku Durrës.

Projekti konsiston në ndërtimin e 2 bazamenteve të depozitave të gazit (nëntokësore) me kapacitet përkatësisht  $15 \text{ m}^3$  (15000 Litra) dhe  $35\text{m}^3$  (35000 Litra), në brendësi të territorit te fabrikës së cimentos. Depozita e parë , do të vendoset në afërsi të hyrjes së fabrikës së cimentos dhe do të shërbejë në repartin e paketimit. Depozita e dytë do të vendoset në afërsi të furrës me klinker dhe do të shërbejë për procesin e ndezjes së saj. Të dyja depozitat do të instalohen nën tokë.




Figura 1: Harta topografike



Figura 2: Harta me vendndodhjen e 2 depozitave brenda fabrikes së çimentos

Vendi/vaska ku do të vendosen depozitat do të kenë këto përmasa (gjërësi-gjatësi-lartësi):<sup>1</sup>

1. Depozita 15 m<sup>3</sup> (15000 Litra) : 340 x 810 x 250
2. Depozita 35m<sup>3</sup> (35000 Litra) : 360 x 1110 x 270

Tabela 1: Koordinatat e projektit në studim

Nr.	Objekti	X		Y
1	Depozita 15 m <sup>3</sup> (15000 Litra)	Pika 1	X=4395003.048	Y=4597064.674
		Pika 2	X=4394996.636	Y=4597067.724
		Pika 3	X=4394995.060	Y=4597064.488
		Pika 4	X=4395001.471	Y=4597061.437
2	Depozita 35m <sup>3</sup> (35000 Litra)	Pika 5	X=4395307.099	Y=4597133.897
		Pika 6	X=4395296.970	Y=4597138.438
		Pika 7	X=4395295.516	Y=4597135.145
		Pika 8	X=4395305.645	Y=4597130.603

<sup>1</sup> Referuar projekt zbatimit te studios projektuese 'K&K Engineering'

## 1 PËRSHKRIM I PROJEKTIT

Projekti konsiston në ndërtimin e dy bazamenteve të depozitave të gazit me kapacitet përkatësisht  $15 m^3$  dhe  $35m^3$  në brendësi të fabrikës së cementos. Depozita e parë, do të vendoset në afërsi të hyrjes së fabrikës së cementos dhe do të shërbejë në procesin e paketimit. Depozita e dytë do të vendoset në afërsi të furrës me klinker dhe do të shërbejë për procesin e ndezjes së saj. Të dyja depozitat do të instalohen nën tokë, si dhe të projektuara me sistemin e mbrojtjes ndaj zjarrit.




Figura 3: Foto nga terreni, vendi ku do të ndërtohet depozita  $15 m^3$




Figura 4: Pamje nga vendi ku do të ndërtohet depozita  $35 m^3$

## Të dhëna kryesore

- Kategoria e objektit : Industrial
- Vendndodhja : Në afërsi të qytetit të Fushë Krujës
- Pajisjet ku do të përdoret : Djegësi i furrës Kiln
- Fuqia e kërkuar :  $Qt = 12\ 420\ 000\ \text{kkal/orë}$  (52Gj/h)
- Presioni i punës së pajisjeve : 0.3 bar
- Debiti i llogaritur : min.625 kg/orë, max.880 kg/orë
- Tubacioni i zgjedhur : tub celiku pa tegel 3"

Projekti eshte i ndarë në këto pjesë :

1. Zona e depozitimit të GLN
2. Sistemi i tubacioneve për dergimin e gazit në destinacion
3. Sistemi i rregullatoreve të gazit, qe sherben për reduktimin e presionit te gazit dhe kontrollimin e regjimit të punës së djegësve.
4. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri.

Projekti i impiantit parashikon vendosjen e një rezervuari të GLN me kapacitet 35000 litra që do të furnizojë me gaz pajisjet. Vendi ku do të vendoset është zgjedhur të plotesojë parametrat dhe distancat e sigurisë të kërkua nga rregulloret përkatëse. Rezervuari është metalik me veshje bituminoze për vendosje nëntokësore i mbërthyer në një bazament të parafabrikuar prej betoni të armuar. Instalimi i tij bëhet në një gropë të hapur me dimensionet përkatëse e më pas mbushjen me rërë lumi. Bashkë me rezervuarin instalohet edhe mbrojtja e tokëzimit të tij. Rezervuari është llogaritur për një presion pune deri në 17.65 bar. Pas përfundimit, rezervuari i nënshtrohet provës hidraulike deri në presionin 25.24 bar.

Në pusetën e rezervuarit janë vendosur pajisjet dhe aparaturat që do të shërbejnë përmarrjen e fazes së gatzë nga rezervuari dhe reduktimin e presionit të tij deri në vlerat e lejuara për pajisjet. Njëkohësisht mbi rezervuar Jane të vendosur valvula e sigurisë, valvola e mbushjes dhe nivel treguesi. Shkarkimi i valvolës duhet të sigurohet që të kryhet në një zonë të sigurtë pa burime ndezje. Në bokaportën e rezervuarit nga jashtë është montuar dhe një pjaster metalike qe shërben përmarrjen në tokën të autobotit. Në pjesën grafike të projektit janë paraqitur në mënyrë të detajuar të gjitha pajisjet e vendosura.

**Furnizimi i rezervuarit me GLN** do të bëhet nëpërmjet autoboteve nga pikat e shkarkimit të tyre. Për të pasur një pavarësi më të plote është parashikuar instalimi i një pompe për shkarkimin e boteve. Lidhja me autobotin do të bëhet me tubo fleksibel të pajisur me valvulat përkatëse, si dhe me pince dhe përcjelles bakri që lidhet me tokën nëpërmjet rezervuarit, përmbrrojtjen nga shkarkimet hidrostatike.

**Gazi pas reduktimit të presionit** do të dërgohet në rampen e kilnit nëpërmjet një tubacioni nëntokësor prej celiku DN80. Linja nga rezervuari do të kalojë nëntokë dhe më pas do ngjitet në nivelin e rampes se kilnit.

Prova për rrjedhje e linjës do të bëhet me presion 1.5 here më të madh se presioni i punës, dhe do të konsiderohet e rregullt nëse për 4 orë rresht nuk do të ketë asnjë lëvizje të presionit, i cili do të matet me manometër të precizionit të lartë. Prova bëhet në prani të presonelit të specializuar të investitorit.

### Djegesi i furrës (burner) Standarti

Duke filluar nga viti 1995 furrat industriale të ndërtuara dhe të vëna në punë e vendet e Bashkimit European duhet të plotësojnë kërkesat e Normave për sigurine e makinerive. Për këtë qellim, me incitaiven e konstruktoreve evropiane të furrave, komiteti evropian i standardeve ka përpunuar standartin EN 746-2 qe aplikohet ne ushqimin me lende djegese dhe djegien. Ne baze te ketij standarti djegësat që ndërtohen duhet të janë të pajisur me aparaturat përkatëse të sigurisë dhe kontrollit të procesit të djegies.

Djegësat e furrave Kiln kanë vecori se duhet të parashikojë përdorimin e tre lëndësh djegëse : pluhur, qymyr gazoil, dhe GPL.

### Mbrojtja e objektit :

#### Gazi i lëngëzuar

Për vetë karakteristika e punës së objektit që do të përdorë lëndë lehtësish të ndezshme, janë parashikuar të merren një sërë masash teknike dhe administrative për të siguruar mbrojtjen dhe sigurinë e punës në objekt :

1. Vendi i zgjedhur për vendosjen e rezervuarit të GLN plotëson të gjitha kërkesat teknike të rregullores së instalimit të pajisjeve të gazit.
2. Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike elektrostatike : për këtë qëllim janë parashikuar tokëzimi i rezervuarit, si dhe lidhje me tokën e autobototit gjatë shkarkimit te tij. Gjithashtu do të tokëzohet tubacioni i dërgimit të gazit cdo 15m sipas skemës. Të gjitha pajisjet dhe materialet që do të përdoren duhet të janë të certifikuara.
3. Mbrojtja e ambientit nga ndotjet : Gazi i lëngëzuar i naftës nuk përbën impakt për ambientin dhe ekosistemin. Megjithatë vetë kushtet e punës së tij si lëng nën presion, aparaturat dhe pajisjet janë të tillë që nuk lejojnë absolutisht asnjë rrjedhje. Përvec kesaj në rezervuar janë vendosur valvola fluksi dhe kundravalvol në të gjitha konjekcionet e tij, me qelli mbllokimin e menjëherëshëm të rezervuarit për cdo rast të konstatimit të rrjedhjeve në tubacione dhe pajisje.
4. Sigurimi në punë dhe mbrojtja nga zjarri :

#### 4.1 : Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë

Pajisjet që shërbejnë në përdorimin e GPL, si dhe materialet që përdoren paraqesin një sërë rreziqesh për personelin punonjës. Këto rreziqe duhet të njihen dhe të kontrollohen me qëllim që të bëhen të padëmshëm, në një nivel të pranueshëm, të përcaktuar nga rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë. Masat për ruajtjen dhe sigurinë në punë përcaktohen nga studimi dhe njohja e procesit të punës si dhe nga njohja e karakteristikave të pajisjeve që do të përdoren. Për këtë qëllim administratori do të hartoje « Rregulloren e shfrytëzimit » dhe rregulloren e « Sigurimit Teknik dhe mbrojtjes në Punë në impiant », me të cilën do të instruktohen punonjësit që do të menaxhojne impiantin. Shkarkimi i botit duhet të kryhet nga persona të kualifikuar duke përdorur pajisjet përkatëse. Materialet me të dhëna për përdorimin e sigurtë duhet të afishohen në mënyrë që të jenë të lexueshme nga të gjithë.

#### 4.2 Pajisjet për mbrojtjen nga zjarri :

Për mbrojtjen nga zjarri është në gatishmëri sistemi MNZ i fabrikës. Në afërsi të rezervuarit të vendoset një hidrant UNI 45 i pajisur me hedhësin dhe tubin me gjatësi 30m. Gjithashtu është parashikuar të vendosen një fikse zjarri me rrota me kapacitet 50 kg, me pluhur polivalent ABC, në afërsi të depozitës së GLN. Do të vendosen 2 fikse zjarri portative me pluhur me kapacitet 6 kg pranë rampës. Në këto ambiente janë parashikuar të vendosen sensorë gazi të cilët detektojnë rrjedhjen e gazit ose ndërprerjen e punës së aspiratorit dhe jepin alarme duke mbyllur njëkohësisht elektrovalvolen e furnizimit me gaz.

Pjesa grafike e Projektit të MNZ përbëhet nga këto skema :

- Planimetria e përgjithshme e objektit
- Skema e fluksit linja e ngarkimit të rezervuarit
- Skema teknologjike e linjës se GLN
- Skema e montimit të rezervuarit dhe grupit të reduktimit
- Skema e vendosjes së rezervuarit të GLN, dimensionet e gropës
- Skema e tokëzimeve
- Skema e mbrojtjes kundër zjarrit.

## 2 PËRSHKRIM I MJEDISIT

### • Flora

Flora e zonës mbizotërohet nga një lloj shkurreje tipike per rajonet e Mesdheut (maquis), pisha (*Pinus heldreichi*), është gjithashtu karakteristike për zonën, këto te fundit janë të mbjella aty prej më shumë se 40 vjetësh. Prezenca e elementeve të tillë si shqopa (*Erica Arborea*), ulliri e egër dhe e kultivuar (*Olea oleaster* dhe *Olea europaea*), lisi (*Quercus Cerris*) etj, janë evidencë që kjo është një zonë tipike mesdhetare. Gjelbërim i lartë në formën e mirfillte të pyjeve është i rrallë

per territorin e bashkësisë, kryesisht pyjet shtrihen në kufi me Krujën dhe kryesisht në bimësi mbizotërojnë speciet e sipërmendura. Si rezultat i shpyllëzimit masiv dhe prerjes pa kriter të pyjeve në zonën e industriale të rënda kemi një tjetërsim të ekosistemit në këto zona. Zonat më të dëmtuara janë territoret e karrierave te gëlqeres dhe argjilës. Heqja e shtresave të dheut dhe të bimësisë në këto zona, do te prishen dhe habitatet e faunës (gjitarët, shpendët, amfibët, zvarranikët) së bashku me cdo lloj specie tjetër që popullon ato zona.

#### • Fauna

Në zonën e Fshatit Zallë speciet shtazore që mund të hasen në kete rajon jane rreth 31 gjitarë, 134 lloje shpendësh (18 prej të cilëve konsiderohen të rrezikuara), 11 lloje amfibësh, 24 lloje zvarranikësh dhe 215 lloje insektesh.

Vrojtimi në terren në zonat kodrinore të rajonit, rezultoi në identifikimin e regjistrimin e një sërë llojesh (shpendë, zvarranikë, amfibë). Fauna e zonës karakterizohet nga prezenca e dhelprës (*Vulpes vulpes*) dhe të lepurit (*Lepus capensis*).

Gjithashtu, ndeshen edhe të tjerë gjitarë si nuselala (*Mustela nivalis*) dhe ketri (*Sciurus vulgaris*). Sigurisht, që bazuar në vendodhjen e habitateve natyrore egzistuese dhe pakësimin e tyre rrjedhimisht për arsyet e gjendjes së disa prej tyre në zonat e pasura me gurë gëlqeror, numri i gjitarëve te zonës është zvogëluar ndjeshëm si pasojë e zvogëlimit të shtrirjes së sipërfaqes së habitatit të tyre natyror. Përsa i përket zones së projektit, nuk do të kete heqje apo pastrime të vegjetacionit. Zona e projektit eshte egzistuese, pjesë e fabrikës e cila është e pastruar nga bimësia.

### 3 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

#### 3.1 Identifikimi i ndikimeve

Vlerësimi i Ndikimeve në Mjedis ka për qëllim identifikimin e ndikimeve në mjedis (Ndikime negative dhe pozitive) të aktivitetit dhe masat e duhura përmirësimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis si rezultat i zhvillimit të projektit.

#### 3.2 Vlerësimi i ndikimeve

Mbështetur në analizën e identifikimit të ndikimeve në mjedis si gjatë fazës së ndërtimit ashtu edhe gjatë fazës së funksionimit të aktivitetit që synon te zhvillohet, në vijm është paraqitur vlerësimi i ndikimeve përmirësimin e ndikimeve në mjedis. Ndikimet janë vlerësuar përmirësimin e ndërtimit të depozitave te gazit dhe fazës së funksionimit të tyre.

Në përfundim të vlerësimit të ndikimeve në mjedis do të paraqitet plani i masave me qëllim shëmangien, reduktimin dhe menaxhimin e ndikimeve të vlerësuara.

### Metoda e vlerësimit së ndikimeve të mundshme negative në mjedis

Tabela 2: Klasifikimi i ndikimit

Vlerësimi	Përshkrimi
<b>Rëndësia</b>	
Pa ndikim	Nuk egzistojnë ndikimet në mjedis.
Ndikim I papërfillshëm	Ndikimi në mjedis nuk do të rezultojë në asnjë ndryshim të dukshëm në vlerën e tij dhe aktiviteti i propozuar do të ketë impakt shumë minimal, thaujse të pakonsiderueshëm në implementimin e tij.
Ndikim I ulët	Projekti ndikon pak në vlerat natyrore duke patur parasysh sasinë dhe cilësinë.
Ndikim mesatar	Vlerat mjedisore do të preken për shkak të shkallës së ndikimit dhe ndjeshmërisë. Ndryshimet janë të përkohshme dhe nuk do të ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë e mjedisit. Duhet të shoqërohet njëkohësisht me masa kontrolluese dhe menaxhuese.
Ndikim I lartë	Ndodh kur aktiviteteti ka gjasa të përkeqësojë gjendjen e mjedisit duke cënuar karakteristikat e tij dhe elementet strukturore të vlerave mjedisore. Projekti shkakton ndryshim madhor në vlerat natyrore dhe habitatin e zonës, shpesh duke u shoqëruar me ndikim të pakthyeshëm (efekti negativ do të vazhdojë në mjedis duke sjellë degradim). Rehabilitimi konsiderohet I vështirë në këtë fazë.
<b>Kohëzgjatja e ndikimit</b>	
Afatshkurtër	Parashikohet të zgjase vetëm për kohëzgjatjen e periudhës së ndërtimit.
Afatgjatë	Që do të vazhdojnë për gjithë jetën e projektit, por pushon kur projektin ndalon operimin.
I përhershëm	Impakte të përhershme që shkaktojnë një ndryshim të përhershëm në receptorin ose burimin e prekur.
<b>Kthyeshmëria (Reversibiliteti)</b>	

I kthyeshëm	Gjasat që një parameter i matur mjedisor do të rikuperohet nga impakti mjedisor përmes teknikave të menaxhimit të mjedisit.
I pakthyeshëm	Dhe pse mund të meren masat rehabilituese, mjedisi nuk mund të kthehet sërisht në gjendjen e mëparshme.

Tabela 3: Shkalla e rëndësise sipas kodit të ngjyrave




Tabela 4: Kohëzgjatja e impaktit

Kohëzgjatja		
Afatshkurter	Afatgjatë	I përhershëm
1	2	3

Ky vlerësim është mbështetur vetëm në disa nga kriteret e listuara më sipër dhe në vecoritë e mjedisit ku do të zhvillohet projekti. Mbi këtë vlerësim do të orientohen edhe masat që duhet të merren për të zbutur ndikimet, të cilat përbejnë dhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit.

### 3.2.1 N dikimi në biodiversitet

#### Flora dhe fauna

##### *Ndikimet gjatë fazës ndërtimore dhe funksionale*

Nga zhvillimi i punimeve ndërtimore nuk do të ketë ndikime në bimësi. Zona e projektit eshte egzistuese, pjesë e fabrikës e cila është e niveluar dhe pastruar nga bimësia. Në këtë menyrë flora dhe fauna nuk do të ndikohen nga punimet per ndertimin e depozitave te gazit. Nga ekspedita e kryer në terren u vlerësua që flora e zonës në afersi të fabrikës është fiziologjikisht normale dhe tipike për një mjedis të pastër. Habitatet ruajnë karakteristikat e tyre tipike mesdhetare të cilat nuk paraqesin tendencë degradimi apo rezikim të zhdukjes së tyre. (*Ndikim i ulët, Afatshkurtër, i kthyeshëm.*)

Përsa i përket fazës së operimit, nuk parashkohet të ketë ndikime në florë dhe faunë (*Ndikim i papërfillshem, afatshkurtër, i kthyeshëm*).

### 3.2.2 N dikimi në ujë

#### *Ndikimet gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit*

Burimet ujore janë në distancë të konsiderueshme nga projekti që synon të zhvillohet dhe nuk do të ndikohet nga ndërtimi apo funksionimi I tij.

##### 3.2.3 NDIKIMET NË TOKË

###### *Ndikimet gjatë fazës së ndërtimit*

Terreni (toka) është komponenti që mund të pesojë ndryshime të lehta gjatë fazës së ndërtimit pasi:

- Do të gërmohet toka, ku do te vendosen depozitat e gazit, por do të rikthehet në fazën e rehabilitimit të terrenit.
- Do të shtrohet zhavor dhe do të kryhet nivelimi i saj etj.
- Punimet per bazamentin e depozitave të gazit do të përfshijnë dhe punimet e betonit (*Impakt Ulët, Afatgjatë, I kthyeshëm.*)

##### 3.2.4 NDIKIMI NË CILËSINË E AJRIT

###### *Ndikimet gjatë fazës ndërtimore*

Gjatë fazës ndërtimore do të ketë shtim të pluhrave dhe gazeve në zonën e projektit, brenda fabrikës. Burimet e krijimit dhe emetimit të tyre do të jenë:

- Punimet për hapjen e zonës së ndërtimit të depozitave ( gërmimi I dheut, punimet e betonit, vendosja e depozitave)
- Qarkullimi i automjeteve në zonë
- Krijimi I dherave, të gjeneruara nga gërmimet

Të gjitha këto bëjnë që në zonë të krijohet mundësia për përhapjen e pluhurave. Ky fenomen është më i lartë në ditët e thata dhe me erë.

Emëtimet e gazeve vlerësohen të jenë në shkallë më të vogël se përhapja e pluhurave, burimet prej të cilave do të emetohen gazet do të jenë:

- Automjetet e punës, nga djegia e karburantit do të emëtohen gazet si NOx, CO, CO<sub>2</sub>, etj, dhe emëtimet nga gjeneratorët elektrik në rast se do të përdoren për raste emergjente.

Këto emëtime në ajër **vlerësohen të jenë në përqëndrime të ulta dhe afatshkurtër, të kthyeshme.** Lidhur më këtë vlerësitet se këto emëtime nuk do ndikojnë në cilësinë e jetës së komunitetit dhe botës së gjallë.

##### 3.2.5 UJËRA TË NDOTURA

Ujërat e ndotura urbane do të menaxhohen me gropë septicë, që kompania I ka tashmë në funksion, në brendësi të territorit të fabrikës.

### 3.2.6 Gaze dhe pluhura

Gjatë ndërtimit do të ketë impakte në ajër, si pasojë e gërmimeve. Do të ketë emetime të (PM<sub>10</sub>, SO<sub>x</sub>, NO<sub>x</sub>, CO<sub>2</sub>) nga makineritë e rënda lëvizëse me diezel apo benzinë, paisjet ndihmëse portative, transportimi i materialeve dhe transporti punonjësve. Ky lloj ndikimi do të jetë i pranishëm në atë pjesë të fabrikës së cementos ku do të punohet për ndërtimin e depozitave të gazit.

Këto çlirime dhe ndikimet e tyre mund të konsiderohen të neglizhueshme, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e kufizuar të fazës së ndërtimit, duhet të theksojmë që ky impakt është afatshkurtër.

### 3.2.7 Zhurma dhe vibrime

Gjatë procesit të zbatimit të punimeve për ndërtimin depozitave të gazit do të ketë punime të tilla si: hapje dhe gërmim dheu, punime e betonit, transporti dhe vendosja e depozitës së gazit. Kompania investitore do të marrë në konsideratë ndikimin e zhurmave dhe do të marrë të gjitha masat për zbutjen e ndikimeve të mundshme negative.

Në mënyrë që impakti të jetë sa më i vogël është e nevojshme që kompania duhet të respektojë normat e përcaktuara në udhëzimin Nr.8, datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave".

### 3.2.8 Mbetjet e ngurta

Gjatë aktivitetit për realizimin e projektit do të ketë krijim të materialit të ngurtë të gërmuar (dherave), si dhe shtresës egzistuese të bazamentit të betonit të njerës prej depozitave (depozita me kapacitet 15m<sup>3</sup>) por jo të dëmshme. Në bazë të ligjit nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" si dhe ligjit 32/2013, datë 14.02.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". Dherat që do të gjenerohen do të ri-përdoren brënda fabrikës për sistemime të ndryshme, nëse do të ketë teprica duhet të menaxhohen në vend-depozitime të përcaktuara sipas marrëveshjes me pushetin vendor. Punimet për prishje betoni (për depozitën egzistuese 15 m<sup>3</sup>), sasitë e inerteve duhet të menaxhohen në mënyrën e duhur, deri në asnjësimin përfundimtar.

Tabela 5: Sasitë e mbetjeve inerte<sup>2</sup>

Volumet e inerteve	
1.Punime prishje betoni(Depozita 15m <sup>3</sup> )	10.8 m <sup>3</sup>
2. Gërmim, dhera (Depozita 15m <sup>3</sup> )	86.3 m <sup>3</sup>
3. Gërmim, dhera (Depozita 35 m <sup>3</sup> )	279 m <sup>3</sup>

<sup>2</sup> Referuar preventivit te punimeve

Transporti i këtyre mbetjeve duhet të kryhet vetëm nga kompani dhe makineri të licensuara me lejet përkate se si dhe të shoqërohet me dokumentin e transferimit të mbetjeve. Përsa i përket mbetjeve të ngurta urbane nga aktiviteti njerëzor, ato do të menaxhohen nga shërbimi i komunës.

Mbetjet që priten të gjenerohen nga projekti janë mbetje inerte, mbetje urbane (letër, plastikë, mbetje ushqimore). Nuk parashikohet të ketë mbetje të rrezikshme (vetëm në rast të ndonjë incidenti si p.sh: derdhje karburanti/vaji nga makineritë në terren).

Mbetjet që do të gjenerohen specifisht do të klasifikohen sipas VKM Nr. 99/2005 "Për miratimin e katalogut Shqiptar të klasifikimit të mbetjeve (I ndryshuar). Në tabelën e mëposhtme paraqiten në mënyrë të përbledhur llojet e mbetjeve të parashikuara për tu gjeneruar gjatë ndërtimit, si dhe kodet respektive sipas VKM.

Tabela 6: Tabela me kodet e mbetjeve

Kodi I mbetjes	Lloji I mbetjes
15 01	Ambalazhe (duke përfshirë mbetjet e paketuara urbane)
15 01 01	Mbetje ambalazhi letre dhe kartoni
15 01 02	Mbetje ambalazh i plastike
17	Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet
17 01 01	Beton
17 05	Dhera
20 01 01	Letër dhe karton

#### 4 KOHËZGJATJA E NDIKIMEVE TE MUNDSHME

Kohëzgjatja e ndikimit është një nga treguesit më të rëndësishëm të ndikimit në mjedis dhe në shëndet. Krahas llojit dhe shkallës së ndikimit kohëzgjatja e tij përcakton nëse jetëgjatësinë ose prezencën e këtij ndikimi në zonën e projektit dhe jo vetëm.

**Ndikim afatshkurtër:** Vlerësohen ato ndikime koha e prezencës së ndikimit në mjedis është e shkurtër, vetëm gjatë fazës ndërtimore.

**Ndikimi afatmesëm:** Vlerësohet ndikimi i cili do të jetë prezent gjatë fazës ndërtimore dhe do të jetë prezent edhe gjatë fazës së vëties në funksion, pra kërkon kohë të rikthehet në gjendjen fillestare.

**Ndikimi afatgjatë:** Vlerësohen ndikimet të cilat janë prezent gjatë kohës së funksionimit të projektit.

Treguesit e vlerësuar	Krakteristikat e ndikimeve	Kohëzgjatja e ndikimeve		
		Afat shkurtër	Afat mesëm	Afat gjatë

<b>Ndikimet në ajër</b>	Krjimi dhe përhapja e grimcave të ngurta (pluhrave)			
	Emëtimi i gazeve nga automjetet e punës			
<b>Ndikimet në Tokë</b>	Gjenerimi i mbetjeve (inerte)			
	Përdorim toke për ndërtimin e depozitave te gazit			
<b>Ndikimet në uji</b>	Përdorimi i ujtit			
<b>Ndikimet në florë</b>	Dëmtim i vegjetacionit natyror	N/A	N/A	N/A
<b>Ndikimet në faunës</b>	Largimi i faunës që ndodhet në dhe përreth zonës së projektit			
Zhurmat	Prania e zhurmave			
<b>Ndikimet negative në komunitet</b>	Emëtimet në ajër			
	Përdorimi i tokës			
	Prania e zhurmave			
	Ndryshimet në peizazh			

\*N/A- Nuk Aplikohet

## 5 MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE

Ky kapitull do të trajtojë masat kryesore të propozuara që duhet të marrë investitori ose kompania zhvilluese për zbutjen apo shmangien e ndikimeve negative të analizuara në kapitujt e mesiperm. Këto masa përfshijnë masa të përgjithshme, masa teknike, inxhinierike për minimizimin e impakteve negative.

### 5.1 Të përgjithshme

Këto masa duhet të synojnë:

- Parandalimin (aty ku është e mundur) dhe minimizimin e impakteve negative në mjedis (ajër, zhurma), gjatë periudhës së ndërtimit dhe funksionimit.
- Sistemimin e dherave (masës inerte) që do të gjenerohet nga punimet.
- Në fund, pas mbylljes se aktivitetit: rehabilitimin e sipërfaqeve që do të afektohen dhe ndikohen nga veprimtaria ndërtimore.

### 5.2 Masat për zbutjen e ndikimeve gjatë fazës së ndërtimit

Tabela 7: Masat për zbutjen e ndikimeve

Lloji i ndikimit	Masa për zbutjen e ndikimit	Efektshmëria e masave
<b>Faza e ndërtimit</b>		
Emëtimet në ajër, si pluhurat dhe gazet	<p>Kontrolli periodik i makinerive për të siguruar emetim brenda normave të lejuara;</p> <p>Planifikimi paraprak i punës dhe realizimi në kohë sa më të shkurtër.</p> <p>Transporti i mbetjeve dhe lëndëve të para për ndërtimë me kamione të mbuluara;</p> <p>Spërkatja me ujë( veçanërisht në kohë të thatë) të zonës së punës;</p>	Ul përqëndrimin e grimcave të ngurta në ajër.
Krijimi i zhurmave	<p>Të mirëmbahen automjetet e punës;</p> <p>Të ndalohet rënia e borive në zonat e banuara;</p> <p>Në zonat e banuara të qarkullohet me shpejtësi të kufizuar;</p> <p>Makinat e transportit dhe pajisjet do të jenë bashkëkohore që plotësojnë standardet kombëtare, të pajisura me marmitë selenciatore të pakësimit të zhurmave.</p>	Ul shkallën e bezdisjes që vjen nga prania e zhurmave.
Ndikimi në botën e gjallë (flora dhe fauna)	<p>Me qëllim reduktimin e ndikimeve në florë dhe në faunë, kompania zhvilluese duhet të zbatojë masa si më poshtë:</p> <p>Të zbatojë masat për reduktimin e zhurmave ;</p> <p>Në përfundim të punimeve ndërtimore kompania të aplikojë masa për sistemimin e dherave.</p>	Ul impaktin në florë dhe në faunë
Gjenerim i mbetjeve	<p>Mbetjet inerte qe do te gjenerohen duhen te menaxhohen ne menyren e duhur ne bashkepunim me pushtetin vendor.</p> <p>Mbetjet urbane vlerësohen të jenë në sasi të vogël, për menaxhimin e tyre kompania të zbatojë këto masa:</p> <p>Kompania ka tashmë në fabrikë, konteniere/kosha të posacme në zonen e punimeve dhe ato të meren çdo ditë nga punonjësit apo një person përgjegjës për tu dërguar në</p>	Shmang përhapjen e mbetjeve në mjedis, mbron mjedisin dhe shmang impaktin viziv të padëshiruar.

Lloji i ndikimit	Masa për zbutjen e ndikimit	Efektshmëria e masave
Faza e ndërtimit		
	kontenierët e përcaktuar nga pushteti vendor.	
Incidente	Kompania investitore do të marrë masa për MNZ (mbrojtje nga zjarri)	Parandalon incidente të mundshme në lidhje me zjarrin.